



*Empowered lives.
Resilient nations.*

PËRFSHIRJA E ÇËSHTJES GJINORE NË POLITIKAT DHE STRATEGJITË PËR PËRSHTATJE NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE ZVOGËLIM TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE





*Empowered lives.
Resilient nations.*

Përfshijja e qëshjeshgjime në Përditshat e stategjive Për Përshtajjen e mbyshinave klinike Zogjimtëne e kutnga faktojës të rastave



Mey Eltayeb Ahmed (PhD)
Këshilltare ndërkombëtare



Të gjitha opinionet, pikëpamjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë raport janë të këshilltares dhe mund të mos paraqesin qëndrimin zyrtar të UNDP-së.

Vërejtje	2
Përbajtja	3
Shkurtesat	4
Falenderim	5
Përbledhje ekzekutive	6

I. HYJE 7

Sfondi.....	7
Synimi dhe objektivat e raportit.....	7
2. Përfaqësimi gjinor në ZRRF dhe PNK.....	7

II. MBDHJA 10**III. REZULTATI DHE KOMENTAT** 10

1. Përbledhje.....	10
2. Konteksti i rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimeve klimatike në Kosovë.....	10
3. Konteksti i barazisë gjinore në Kosovë	13
4. Çështja gjinore në planifikimin e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.....	14
(a) Vrojtimet e palëve të interesit.....	16
(i) Barazia gjinore dhe ligjet	27
(ii) Zhvillimi i kapacitetit dhe institucioneve	17
(iii),(iv),(v) & (vi). Pjesëmarrja, zhvillimi i PNK dhe ZRRF, si dhe partneritetet dhe bashkërendimi gjithëpërfshirës.....	18
(vii) Mbështetja financiare dhe financimi	18

IV. REFERENCË 19**V. NËKOMODIMI DHE RATHIMI** 20

A) Bashkërendimi.....	21
Shtrirja kohore e planit të veprimit	21
B) Gjinia, ligjet dhe politikat.....	24
Shtrirja kohore e planit të veprimit	24
C) Financimi	25
Shtrirja kohore e planit të veprimit	25
D) Zhvillimi i kapaciteteve	27
Shtrirja kohore e planit të veprimit	27

V. TËLIMOGJAJA 29**VI. SHTOJÇA** 30

Shtojca 1: Orari i intervistave	30
Shtojca 2: Lista e pjesëmarrjes në punëtorinë dy-ditore	31



	Nisma e Zyrës për parandalim dhe rimëkëmbje të krizave të Programit zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP/BCPR)
	Nisma për ngritjen e kapacitetit për zvogëlim të fatkeqësive
	Plani i përbashkët zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
	Diskutimet në fokus grupe
	Dhuna në baza gjinore
	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
	Organizata për ushqim dhe bujqësi, OKB
	Iniciativa për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë në Kosovë
	Komisioni evropian
	Komiteti kosovar përfshirjen e faktorit gjinor në PNK dhe ZRRF
	Kapaciteti përshtatës
	Korniza e veprimit e Hygros
	Ligji për barazi gjinore
	Bashkësia e personave lezbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinorë
	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor
	Ministria e punëve të brendshme
	Ndryshimet klimatike
	Zyra e Kombeve të Bashkuara për bashkërendim të çështjeve humanitare
	Organizatat joqeveritare
	Organizatat e shoqërisë civile
	Plani kombëtar i reagimit
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
	Plani i veprimit i programit të UNDP-së në Kosovë
	Sistemi i integruar për menaxhimin e emergjencave
	Strategjia kombëtare e përshtatjes
	Strategjia për ndryshimet klimatike
	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
	Fondi për familje dhe popullsi i Kombeve të Bashkuara
	Programi i vendbanimeve njerëzore i Kombeve të Bashkuara
	Organi i Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe fuqizim të grave



Raportipërpërfshirjene çështjes gjinore në zgjelimin e vengafatkeqësitë dhënë nga përshtatjet e ndaj ndryshimeve klimatike është rezultat i intervistave individuale, ideve të ndryshme në grup dhe diskutimeve në fokus grupe. Raporti dhe rekomandimet e tij nuk do të mund të realizohen pa ndihmën e institucioneve kryesore të Kosovës¹, organizatave joqeveritare, Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara të cilat veprojnë në Kosovë. Si dhe, realizimi i hulumtimit nuk do të kishte qenë i mundur pa financimin dhe përkrahjen logjistike të projekteve të UNDP-së, "Iniciativa për Zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë në Kosovë (KDRRI) dhe Përkrahje për zhvillim me emetim të ulët (SLED).

Iu jemi mirënlohës dhe i falenderojmë znj. Zana Hoxha-Edip (Menaxhere projekti në UNDP-KDRRI), z. Shigehiro Shibata (Sigurimi i cilësisë në UNDP), Shkipe Deda-Gjurgjiali, Dea Haxhi, Xhevrije Berisha, Valbona Bogujevci, Njomza Çarkaxhiu dhe Zeqir Ademi. Gjithashtu i jemi mirënlohës ekipit të UNDP-së në Kosovë dhe znjsh. Brikena Sylejmani (Zyrtare për barazi gjinore në UNDP-së) përkrahjen e saj gjatë procesit të intervistemit dhe mbajtjes së punëtorisë.

I falenderojmë të gjithë njerëzit që shprehën hapur mendimet e tyre rreth përfshirjes së çështjes gjinore në Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike (PNK) dhe Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitetë Natyore (ZRRF), pa kufizime, dhe që gjetën kohën për t'i dëgjuar pyetjet e hulumtimit dhe për të dhënë përgjigje të hapura. Iu jemi thellësishët mirënlohës znjsh. Edona Hajrullahu nga ABGJ, z. Mustafë Gashi nga AME, znjsh. Shpresa Sheremeti nga MMPH, znjsh. Emine Kelmendi nga MBZHR, znj. Rezan Zborca dhe znjsh. Venera Dibra nga MPB, z. Xhelal Sveqla nga Komuna e Prishtinës/Priština, znj. Iliriana Jaka Gashi nga organizata "Women for Women", znjsh. Eliza Hoxha nga Universiteti i Prishtinës, znjsh. Brikena Sylejmani nga programi Politika, Hulumtime dhe Barazi Gjinore e Komunikim i UNDP, z. Aleksandar Nikolovski nga OUB, znjsh. Arijeta Himaduna nga UN-Habitat dhe znjsh. Linda Abazi nga Fondi për popullsi i Kombeve të Bashkuara.

Në përmbyllje, këshilltarja dëshiron të falenderojë UNDP-në për mundësinë që të ndihmoja këtë proces për ju. Kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen dhe pjesëmarrjen e plotë gjatë punëtorisë dyditore, ku u përfshinë Ministria e punëve të brendshme, Agjencia për menaxhimin e emergjencave, Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, Agjencia për barazi gjinore, Ministria e zhvillimit ekonomik, rrjeti i grave të Kosovës, Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Komuna e Prishtinës/Priština, OJQ-ja "Women for Women", programi gjinor i UNDP-së, UN-Women, KDRRI e UNDP-së dhe SLED.

¹ Emërtimi i Kosovës do të kuptohet nën kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurisë 1244 (1999)



Raport jep rezultatet dhe rekomandimet e **konsulencës për rishikimin e përfaqësimit gjinor të realizuar gjatë periudhës shtator-tetor 2014**, me qëllimin për të vlerësuar gjendjen e përfshirjes të aspektit gjinor në legjislacionin, politikat dhe strategjitet e Kosovës në ndërlidhje me Zvogëlimin e rezikut nga fatkeqësitetë (ZRRF) dhe Ndryshimet klimatike (NK).

Që prej vitit 1999, Kosova ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të garantuar kornizë të fuqishme ligjore për barazinë gjinore, si dhe për ZRRF dhe NK. Megjithatë, ende ka mangësi të shumta si në legjislacion ashtu edhe në proces; për më tepër, realizimi i tyre mbetet një segment që po pengon aftësinë e Kosovës për të ecur përpëra në lidhje me qasjet ndaj ZRRF dhe NK të cilat marrin parasysh çështjen gjinore.

Kosova përballet me përmbytje e zjarre, ndërsa edhe infrastruktura e saj është e dëmtuar si pasojë e luftës së fundit, gjë që nënkupton se, si një vend në rimëkëmbje e sipër, Kosova duhet të rindërtojë dhe rizhvillojë infrastrukturën, por në mënyrë paralele me këtë duhet të i kushtojë vëmendje rrethanave mjedisore dhe klimatike. Edhepse Kosova ka popullsi të re, me një numër gjithnjë e më të madh të meshkujve e femrave me arsimim të lartë, të cilët paraqesin një fuqi punëtore të kualifikuar për të ardhmen, si dhe ka platformë ligjore gjithëpërfshirëse dhe me një numër mekanizmash e strategjish për barazi gjinore, prap se prapë shoqëria tradicionalisht patriarkale e Kosovës dhe mungesa e zbatimit të këtyre mekanizmave dhe strategjive mbeten sfida kryesore për përfaqësimin gjinor. Mirëpo, Kosova ka ndërmarrë hapa pozitivë, si ndërlidhja e ZRRF me NK, ndërsa UNDP-ja ka zhvilluar një nismë tejet të mirë, projektin Iniciativa për zvogëlim të rezikut nga fatkeqësitetë në Kosovë, i cili përcakton qëllime, objektiva dhe rezultate të arritshme.

Për të përfshirë çështjen gjinore në planet ekzistuese të ZRRF dhe NK në Kosovë, hulumtimi i përqendruar te pjesëmarrësit/ palët e interesit nxori në pah që nevojiten katër rezultate: (a) Udhërrëfyesi i politikave për ZRRF/ NK që marrin parasysh çështjen gjinore; (b) Vlerësimi i rezikut që merr parasysh çështjen gjinore; (c) Sistemet e paralajmërimit të hershëm që marrin parasysh çështjen gjinore; dhe (d) Treguesit e ZRRF dhe NK që marrin parasysh çështjen gjinore.

Për të realizuar këto, Kosova duhet të jetësojë legjislacionin dhe ligjet mbi barazinë gjinore, duke ndërlidhur dhe fuqizuar të gjitha kornizat, politikat dhe strategjitet e veta institucionale në nivel qëndror, komunal dhe vendor; ajo gjithashtu duhet të ndërtojë objektet, të hartojë plane veprimi në nivel qendror në Kosovë, si dhe të ndajë buxhet për të mbështetur përfaqësimin gjinor.

Si përfundim del se për të zhvilluar këto aspekte në mënyrë efektive dhe praktike, Kosovës i duhet një **organ/komitët harmonizimi**, një **shqyrtim** i hollësishëm i mangësive dhe ndikimit të **ligjeve dhe legjislacionit ekzistues, përkrahje financiare**² dhe, në fund, **zhvillimi i kapaciteteve**. Zhvillimi i kapaciteteve është i domosdoshme dhe ndërlidhet me të gjitha fushat e tjera, meqënëse mungesa e njohurive, të të kuptuarit dhe përcaktimit të përparësive sa i përket nevojës për përfaqësim gjinor pengon aftësinë e Kosovës për bashkërendim të suksesshëm, për analiza gjinore dhe për të garantuar mbështetjen e nevojshme financiare.

Në përmbyllje duhet të theksohet se, raporti jep rekomandimet dhe një plan veprimi të nivelit makro, për një periudhë 2.5 vjeçar (me 3 fazë), për të nxjerrë në pah fushat e nevojshme, për të zhvilluar dhe përbushur rezultatet e përcaktuara me KDRRI-në e Kosovës gjatë një periudhe dyvjeçare, me një periudhë përfundimtare gjashtë mujore të ndarë për procesin e shqyrtimit dhe përshtatjes, duke përfshirë një rishikim të thellë, për të mudësuar integrimin e planit të veprimit për përbushje të objektivave gjinore të KDRRI-së.

² UNDP - Dokumenti i projektit KDRRI, 2013.

I. Hygje

Raporti është rezultat i **konsulencës për rishikimin e përfaqësimit gjinor gjatë periudhës shtator-tetor 2014** të realizuar nga UNDP-ja në Kosovë. Termat e referencës e angazhojnë këshilltaren me këto detyra:

1. Të identifikonte dhe shqyrtonte përparësitë dhe mangësitë në rregulloret ekzistuese për ZRRF dhe PNK sa i përketë aspektit gjinor;
2. Të organizonte punëtorinë mbi vetëdijësimin për çështjen gjinore në ZRRF dhe PNK; dhe
3. Të hartonte rekomandimet për veprimet e ardhshme në lidhje me strategjitet, politikat, legjislacionin dhe rregulloret e ZRRF dhe PNK ashtu që të marrin parasysh çështjen gjinore.

Sintesi

Fatkeqësitë natyrore dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike (PNK) nuk bëjnë dallime, ndërsa njerëzit po. Kushtet aktuale shoqërore-ekonomike bëjnë që fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike (NK) të kenë ndikime të ndryshme në komunitete të ngjashme për nga demografia - mirëpo në mënyrë të pashmangshme grupet më të cenueshme do të pësojnë më shumë. Hulumtimet kanë treguar që fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike rritin pabarazinë gjinore, duke bërë kështu që situatat e këqija të jenë edhe më të rënda për femrat. Në botë jo rallë herë anashkalohet ndihma që femrat mund të ofrojnë për zvogëlim të rezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike si dhe roli udhëheqës i femrave për rimëkëmbje dhe përshtatje të komuniteteve ndaj fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike..

Synimi dhe objektivat e raportit:

Në këtë kontekst, raporti synon zhvillimin e platformës për planin e veprimit për Kosovë duke përbushur tre objektivat e mëposhtme:

- y Rritja e të kuptuarit të çështjeve dhe nevojave gjinore në ZRRF/NK;
- y Zhvillimi i kapacitetit të institucioneve të Kosovës për trajtimin e çështjeve gjinore në kuadër të ZRRF/NK;
- y Nxitja e institucioneve të Kosovës për të ndërmarrë masa përfshirjen e këndvështrimit gjinor në legjislacionin, politikat dhe programet e ZRRF/PNK për zhvillim të qëndrueshëm.

Platforma Hyogo definon rëndësinë e përfshirjes së çështjes gjinore në politika dhe programe si parakusht për ZRRF/PNK të suksesshme. Ajo parashevë nevojën për pesë fusha:

- y Procesi politik kërkon që organet e Kosovës të krijojnë një mjedis që mundëson ZRRF;
- y Procesi teknik thekson rolin dhe zbatimin e shkencës dhe teknologjisë në ZRRF;
- y Procesi shoqëror-arsimor përqendrohet në mënyrat përritjen e të kuptuarit, njojurive dhe shkathtësive të qytetarëve rreth zvogëlimit të reziqeve nga fatkeqësitë;
- y Procesi zhvillimor definon rëndësinë dhe nevojën përfshirjen e ZRRF në praktikazhvillimore; dhe
- y Procesi humanitar thekson rëndësinë e gatishmërisë përfshirjen e faktorit ZRRF në gatishmërinë dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë.

2. Përfaqësimi gjinor

Përfaqësimi gjinor është proces që synon trajtimin e problemeve dhe nevojave të të dyja gjinive. Ky proces synon fuqizimin gjinor dhe duhet të trajtojë përjashtimet gjinore, diskriminimin dhe

dhunën me bazë gjinore. Burrat duhet të përfshihen në këtë proces për të garantuar suksesin dhe qëndrueshmërinë e tij, si dhe për të rritur barazinë gjinore për të gjithë. Sa i përket përfaqësimit gjinor në ZRRF dhe PNK, ai duhet të përqendrohet në:

- y Fuqizimin e pjesëmarrjes dhe rolit udhëheqës të femrave në vendimmarrje për të garantuar qasje dhe kontroll të barabartë të burimeve; dhe
- y Rritja e mbrojtjes së grave nga fatkeqësitet natyrore dhe nga pasojat e ndryshimeve klimative përmes përmirësimit të aftësive të grave përshtatje dhe reagim.

Në këtë drejtim, për ta përfshirë çështjen gjinore në planet ekzistuese të ZRRF dhe PNK në Kosovë, nevojiten katër resultate:

- (a) Udhërrëfyesi për ZRRF/PNK që merr parasysh çështjen gjinore;
- (b) Vlerësimi i rezikut që merr parasysh çështjen gjinore;
- (c) Sistemet e paralajmërimit të hershëm që marrin parasysh çështjen gjinore; dhe
- (d) Treguesit e ZRRF dhe PNK që marrin parasysh çështjen gjinore.


Për të përbushur këto veprime, legjislacioni dhe ligjet e Kosovës mbi barazinë gjinore duhet të zbatohet, të ndërlidhen dhe fuqizohen me të gjitha platformat, politikat dhe strategjitë institucionale në nivel qëndror, komunal dhe vendor. Përveç kësaj, është e rëndësishme përfaqësimi gjinor duhet të ndihmohet me zhvillim të planeve kombëtare të veprimit dhe alokimine një fondeve të veçantë.

Më poshtë, është shpjeguar metodologjia e zbatuar për të përfituar të dhënat e nevojshme si dhe për të përfshirë palët e rëndësishëme të interesit, në një proces gjithëpërfshirës, me qëllim të zhvillimit të qasjes që garanton përfshirjen e çështjen gjinore në procese të ZRRF dhe PNK në Kosovë.

II. Metodologjia

Studimi i kryer për këtë raport përdori metoda të ndryshme, duke përfshirë shqyrtimin e literaturës, një periudhë tre-ditore të investimit të palëve të interesit dhe një punëtori dy-ditore [shihni diagramin (1)].

Diagrami (1): Metodologjia dhe metodat e hulumtimit



Shqyrtimi i literaturës përfshiu të gjitha dokumentat dhe raportet rreth barazisë gjinore, Strategjinë e ndryshimeve klimatike të Kosovës, Nismën e Kosovës për zvogëlim të rezikut nga fatkeqësitet (KDRRI), Planin kombëtar të reagimit (PKR), Sistemin e integruar të menaxhimit të emergjencave (SIME) të Kosovës, Profilizimin gjinor të Kosovës, Raportin mbi statusin e jetësimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Ballkanin Perëndimor, Strategjinë për barazi gjinore të UNDP-së në Kosovë, Ligjin nr. 2004/2 mbi barazinë gjinore në Kosovë, Ligjin nr. 04/L-012 mbi mbrojtjen nga zjarri dhe Ligjin nr. 04/L-027 mbi mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe të tjera.

Janë realizuar trembëdhjetë intervista gjysmë të strukturuara dhe diskutime sy-më-sy me palët të ndryshme të interesit, duke përfshirë shtatë intervista me institucionet e Kosovës, shtatë me të agjencive të Kombeve të Bashkuara, një me përfaqësues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe një me përfaqësues të një OJQ-je. 13 intervistat janë bërë në Prishtinë /Priština ndërmjet datës 15 dhe 17 shtator 2014. Rezultatet e intervistave nxorën në pah çështjet dhe shqetësimet kryesore të palëve të interesit për të cilat duhen ndërmarrë masa me qëllim të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm përfshirjen e çështjes gjinore në strategjitet e rreziqeve nga fatkeqësitet dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Ndërmjet 14 dhe 15 tetorit 2014 është mbajtur një punëtori në Prishtinë/Priština. Në atë janë përdorur metoda të diskutimit në fokus grupë dhe teknika e ideve të ndryshme në grup (brainstorming), ndërsa morën pjesë përfaqësues nga agjenci të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, institucionet qeveritare të Kosovës dhe një numër i OJQ-ve. Në puntëtori janë zhvilluar diskutimet të hollësishme të të cilat nxorën një sërë rekomandimesh tematike të bazuara në mangësitë kryesore të përcaktuara gjatë intervistave dhenitës së parë të diskutimeve në punëtori.



znj. Leonora Selmani, përfaqësuese e AgE, në zyrën e kryeministrit; zana Hoxha, menaxhere projekti e KDDrl; shigehiro shibata, unDP dhe Mey Eltayeb Ahmed, këshilltare e unDP-së.

Në ditën e parë të punëtorisë, pjesëmarrësit u përqendruan në identifikimin e çështjeve, mangësive dhe përjashtimeve gjinore në kuadër të platformës ligjore të Kosovës për ZRRF dhe PNK, duke përfshirë veprimtaritë bujqësore, aspektet shoqërore-ekonomike, ZRRF-në e Kosovës dhe strategjinë e ndryshimeve klimatike të Kosovës. Pjesëmarrësit gjithashtu diskutuan konceptin gjinor në raport me PNK dhe ZRRF. Pasuan katër diskutime në fokus grupe për identifikimin dhe

shtjellimin e rekomandimeve bazuar në mangësitë dhe sfidat e identikuara në përfshirjen e çështjes gjinore në ZRRF dhe PNK. Gjatë ditës së dytë, pjesëmarrësit shqyrtuan dhe finalizuan rekomandimet nga dita paraprake, duke i specifikuar dhe përqendruar ato më tej për të krijuar bazën e një plani veprimi. Ndër të tjera, pjesëmarrësit shtjelluan nevojën për bashkërendim më të frytshëm dhe të përqendruar për përfshirjen e çështjes gjinore në PNK dhe ZRRF.

Duke punuar sipas procesit të shtjelluar më lart, këshilltarja³ nisi procesin e mbledhjes së të gjitha të dhënavë, duke përfshirë të shkruarit e të gjitha shënimëve të intervistave, dokumentimin dhe organizimin e të gjitha diskutimeve te regjistruala dhe rekomandimet. Më poshtë janë dhënë rezultatet e këtij procesi të bazuar në metodologji gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse.

III. REZULTATET DHE KUTI

Në këtë kapitull janë dhënë dhe janë diskutuar rezultatet e shqyrtimit të literaturës dhe procesit këshillues me palët e interesit.

1. Përbledhje

Kosova ka popullsi të re, me numër gjithnjë e më të madh të meshkujve e femrave me arsimim të lartë që përfaqësojnë një fuqi punëtore të kualifikuar për të ardhmen. Kosova gjithashtu ka një platformë ligjore gjithëpërfshirëse dhe një numër mekanizmash për barazi gjinore. Ajo ka edhe një larmi të strategjive të cilat specifikojnë dhe përcaktojnë planet për realizimin e detyrimet ligjore të institucioneve të Kosovës.

Edhepse Kosova ka një larmi të ligjeve, të politikave dhe të strategjive për trajtimin e barazisë gjinore, ZRRF dhe PNK, shkalla e zbatimit të tyre mbetet ende e ulët. Për më tepër, mungon ndërlidhja ndërmjet dokumenteve të shumta në Kosovë në aspektin e procesit dhe procedurës, ku çështja gjinore përjashtohet si pasojë e të menduarit dhe proceseve jopërfshirëse, si dhe si pasojë e mungesës së mekanizmave të efektshëm të bashkërendimit.

Përkundër këtyre sfidave, Kosova është në pozitë të mirë për të garantuar përfshirje gjinore nëse i jep përparësi përfaqësimi gjinor, duke përfshirë sigurimin e fondeve të nevojshme dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit.

Pjesët në vijim paraqesin kontekstin e profitit të fatkeqësive mjedisore të Kosovës, planifikimit të ZRRF dhe PNK, si dhe të vrojtimeve të palëve të ndryshme të interesit brenda Kosovës.

2. Konteksti i rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimeve klimatike në Kosovë

Që prej fundit të luftës më 1999, Kosova ka përjetuar një lulëzim ndërtimesh si asnjë herë më parë dhe mjaftë të pakontrolluar, si dhe një shtim të urbanizimit. Si pasojë e ndërtimeve pa leje në zona të rrezikshme dhe e moszbatimit të standardeve ndërtimore është rritë ceneshmëria strukturelle ndaj tërmeteve dhe vërvshimeve. Poashtu, ceneshmëria është përkeqësuar edhe si pasojë e shkatërrimit të ndërtesave gjatë konfliktit dhe mungesës së mirëmbajtjes. Planifikimi i dobët i sistemeve të kullimit dhe kanalizimit në zonat urbane ka rritur gjasat e vërvshimeve dhe mund të prekë edhe rezervat e pambrojtura të ujit.⁴

³ Dr. Mey Eltayeb Ahmed, nga Sudani. Përzgjedhur nga lista e ekspertëve të UNDP-së për gjini, mjedis, ndryshime klimatike dhe zhvillim të qëndrueshëm.

⁴ Banka Botërore, 2005, Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Përkrahja e mundësive, sigurisë dhe pjesëmarrjes për të gjithë, raporti nr. 32378- XK.

Shfrytëzimi i papërshtatshëm i tokës dhe planifikimi komunal ishin faktor të rëndësishëm të cilët kontribuan për vërshimet e mëdha te cilat ndodhën në qytetin e Ferizajt më 1973.⁵ Për më tepër, sipas një studimi të OSBE-së në Kosovë, ka pasur shpërthim ndërtimesh pa leje dhe vendbanimesh joformale, transaksionet joformale dhe pa leje vazhdojnë të paprekura, mbetet i pranishëm edhe okupimi ilegal i pronave, ndërsa sistemi kadastral dhe regjistri i të drejtave të pronësisë janë ende të papërfunduara, prandaj edhe të pasakta.⁶

Për shkak të shkallës së lartë të varfërisë dhe ekonomisë së brishtë, ceneshmëria shoqërore-ekonomike mbetet e lartë, gjë që përkreqësohet edhe nga ofrimi i kufizuar i shërbimeve shëndetësore, mirëqenies shoqërore dhe punësimit. Menaxhimi i paqëndrueshëm i ujit dhe praktikat e paqëndrueshme agronomike, shpyllëzimi, si dhe shkatërrimi i tokave malore për shkak të miqjes përfaqësojnë fusha të shqetësimit përmjetin.⁷ Në këtë kontekst, ceneshmëria e popullsisë së Kosovës është e lartë, ku fatkeqësitet e shkallës së vogël mund të kenë ndikim tepër të fuqishëm në jetën e njerëzve.

Në përgjithësi, Kosova përdor dy korniza të Kombeve të Bashkuara që përbajnjë elemente mbi zvogëlimin e rezikut nga fatkeqësitet: Planin e përbashkët zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (PPZH) 2011-2015 the Planin e veprimit përmjet programin në Kosovë (PVPK) 2011- 2015. Plani i përbashkët zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (PPZH) 2011-2015 përqendrohet në Ekipin Kosovar të Kombeve të Bashkuara (EKKB) dhe harmonizimin e punës së tij. Në këtë ekip bëjnë pjesë agjenci, fonde dhe programe të ndryshme të Kombeve të Bashkuara,⁸ në katër tema strategjike: I Platformat legjislative dhe politikat përfshirje shoqërore; II Llogaridhënia përmjetit të rezultateve; III Pjesëmarrja dhe fuqizimi vendor; dhe IV Shëndeti dhe mbrojtja mjedisore.⁹

Kosova ka Strategjinë¹⁰ dhe ZRRF.¹¹ Objektiva 2 e strategjisë përmjet ndryshimet klimatike përmend femrat krahas grupeve të tjera të marginalizuara dhe të ceneshme të shoqërisë:

[...] Zgjerimi i kapaciteve të përshtatjes¹² të sistemeve natyrore, në veçanti ekosistemëve të ceneshme dhe shoqërisë, në veçanti i komuniteteve të ceneshme, siç janë fermerët e varfër, grupet e marginalizuara dhe gratë, përmjet trajtimin e ndikimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura me jetën dhe jetesës së tyre [...]

Ajo vazhdon të thotë:

[...]Strategjia do të synojë që të aplikojë mekanizma të ri dhe t'i përmirësojë ata aktualë përmjet zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitet, të cilat janë me peshë përmjet sektorët e rëndësishëm ekonomikë të cilët janë posaçërisht të ceneshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, si dhe përmjet zgjerimin e kapacitetit të përshtatjes të sistemeve natyrore, në veçanti ekosistemëve të ceneshme, dhe shoqërisë, në veçanti komuniteteve të ceneshme, siç janë fermerët e

5 UN-HABITAT Kosovë, 2009, Identifikimi i rezikut nga fatkeqësitet në planifikimin hapësinor përmjet zhvillimit të qëndrueshëm: Studim rasti në Kosovë.

6 OSBE, qershor 2011, Tetë vjet më vonë: Kthimi i minoritetave dhe dëmshpërbërimi i shtëpisëve përmjet pronave në Kosovë.

7 Fetah Halili dhe Agim Gashi, 2009, Raporti përbashkët kombëtar mbi hulumtimet mjedisore në Kosovë (në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit); Banka Botërore, 2005, Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Përkrahja e mundësive, sigurisë dhe pjesëmarrjes përmjet gjithë raportit nr. 32378- XK.

8 UNDP, UNICEF, UNFPA, UNHCR, OHCHR, WHO, FAO, ILO, UN-HABITAT, UNOPS, UNWOMEN (formerly UNIFEM), UNV, UNESCO, UNEP, UNCTAD, UNODC, UNIDO (IOM është pjesë e EKBK, si edhe Banka Botërore dhe IMF, por nuk janë agjencit të Kombeve të Bashkuara).

9 Këto përfaqësojnë përparësitet dhe përgjegjësitet kryesore të agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, që ndërthurren me angazhime të tjera të rëndësishme zhvillimore.

10 Strategjia përmjet ndryshimeve klimatike në Kosovë, Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor (MMPH), Kosovë, 2014.

11 UNDP (2013) "Nisma përmjet zvogëlimin e rezikut nga fatkeqësitet në Kosovë (KDRRI)".

12 Kapaciteti përshtatës: Aftësia e një sistemi përmjet përshtatur ndryshimeve klimatike, përmjet ulur dëmet e mundshme apo përmjet shfrytëzuar shanset e ndryshme dhe përmjet përbashkët zhvillimit klimatik (IPCC, 2001).

varfër, grupet e marginalizuara dhe gratë, për trajtimin e ndikimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura në jetët dhe mjetet e jetesës së tyre. Në këtë mënyrë, Strategjia Kombëtare e Përshtatjes ka për qëllim ngritjen e kapacitetit të partnerëve, akterëve dhe palëve të interesit lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit lokal dhe rajonal, si dhe fuqizimin e tyre për trajtimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike. [Theks i veçantë]

Në nivel të UNDP-së, korniza përpesë vjetët e ardhshëm (2011-2015) përfshin Planin e veprimit për programin në Kosovë të UNDP-së 2011-2015 (KPAP), një dokument i rëndësishëm ku Zvogëlimi i rreziqeve nga fatkeqësitetë është element parësor në kuadër të fushës së qeverisjes demokratike. PVPK-ja vë themelin për kornizën e programit të ZRRF-së në Kosovë përmes rezultatit 3:

"Deri më 2015, institucionet qendrore dhe vendore do të trajtojnë më mirë ndikimin shëndetësor, shoqëror dhe ekonomik të shkatërrimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike duke marrë parasysh çështjen gjinore."

Si dhe rezultatit 3.1:

"Do të zhvillohet kapaciteti i institucioneve vendore dhe qendrore, si dhe do të themelohet mekanizmi bashkërendues për menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitetë"

Ky rezultat përqendrohet specifisht në çështje që kanë të bëjnë me zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitetë duke zhvilluar kapacitetin e institucioneve vendore dhe qendrore, si dhe duke garantuar bashkërendimin dhe mekanizmin për menaxhim të rreziqeve nga fatkeqësitetë.¹³

Në kuadër të veprimtarive të ZRRF-së, OCHA hartoij një raport vlerësimi të misionit për Kosovën në shkurt 2008. Misioni ofroi rekomandime përfundim që përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitetë në procese të zhvillimit të rimëkëmbjes pas fatkeqësive është element jetik i zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm.¹⁴

Gjithashtu, Kosova mori pjesë në Projektin e UNDP-së për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitetë në Evropën Juglindore (të financuar nga Instrumenti për para-anëtarësim i Komisionit Evropian (KE), 2008), i cili kishte përsnim përmirësimin e kapaciteteve të Kosovës dhe rajonale për ZRRF. Në dialogun e politikave të Kosovës mbi zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitetë, të mbajtur më 7 dhe 8 shtator 2010 në Prishtinë/ Priština, u diskutuan dhe miratuan rekomandime për vlerësim fillestar (me pjesëmarrje të ministrite përkatëse, të përfaqësuesve të komunave, Kryqit të Kuq të Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, institucioneve shkencore dhe organizatave ndërkombëtare). Gjatë marsit 2011, në Kosovë është mbajtur vlerësimi i kapacitetit përfunduar në kapacitetet e Kosovës për ZRRF. Vlerësimi është marrë me pesë fusha teknike të zhvillimit të kapaciteteve: pronësia, rregullimet institucionale, kompetencat, mjetet dhe burimet e punës, si dhe marrëdhëniet. Bazuar në gjetjet, Raporti i vlerësimtit të kapaciteteve ka identifikuar mangësitë dhe sfidat kryesore rreth ZRRF, si dhe ka dhënë rekomandime rreth pesë fushave prioritare të veprimit të Kornizës Hyogo është hartuar dhe përfunduar në gusht 2011.¹⁵ Raporti thotë,¹⁶

13 UNDP (2013) "Nisma për zvogëlimine rrezikut nga fatkeqësitetë në Kosovë (KDRRI)".

14 OCHA, 2008, Roli dhe përgjegjësitetë e ekipit të Kombeve të Bashkuara për menaxhim të fatkeqësive.

15 CADRI, prill 2011, Raporti i vlerësimtit të kapaciteteve përfunduar në Kosovë. <http://www.cadri.net/en/where-we-work/kosovo> [së fundmi e lexuar më 24 tetor 2014].

16 CADRI, prill 2011, Raporti i vlerësimtit të kapaciteteve përfunduar në Kosovë. At <http://www.cadri.net/en/where-we-work/kosovo> [së fundmi e lexuar më 24 tetor 2014].

"Kosova (sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit) priret të ketë tërmete, përmbytje, rrëshqitje dheu, thatësira, të reshura të mëdha bore, shpërthime të pendave të rezervuareve të ujit dhe zjarre pyjore. Që prej fundit të luftës më 1999, Kosova ka përjetuar një lulëzim të paparë ndërtimesh dhe rritjeje të zonave urbane, gjë që, nëse nuk kontrollohet siç duhet, mund të paraqesë kërcënëm serioz duke e rrezikuar popullsinë, sidomos kur janë në pyetje përmbytjet. Rreth 43 përqind e territorit të Kosovës është i mbuluar nga pyjet dhe shkurret. Prej 2000-ëska pasur rritje të numrit të zjarreve pyjore. Kosova ndodhet në një hapësirë me aktivitet seizmik. Tërmeti i fundit i shkallës 5.2 (2012) në pjesën lindore të Kosovës thekson rëndësinë e ndërmarrjes së masave për ulje të rreziqeve dhe përgatitjes për reagim." [Theks i veçantë]

3. Konteksti i barazisë gjinore në Kosovë

Një numër faktorësh pengojnë aftësinë e Kosovës për avancimin e barazisë gjinore. Megjithëse korniza ligjore e Kosovës është deri diku gjithëpërfshirëse,¹⁷ realizimi i tyre mbetet sfidues. Për më tepër, aty ku realizimi ka përparuar deri në fazën e përgatitjes së planeve të veprimit, mungon bashkërendimi efektiv, gjë që rezulton në duplikim. Strategjitet ekzistuese dhe të zhvilluara për çështje gjinore, kanë mungesë të fondeve. Kjo vështirësitet edhe mëtej nga fakti që institucionet e Kosovës dhe personeli i tyre në nivele të ndryshme mund të mos e kuptojnë nevojën përfaqësim gjinor apo nuk kanë njohuri si ta praktikojnë. Si rrjedhojë, çështjet gjinore mbeten të përjashtuara, të pafinancuara, të keqkuptuara apo të nënverhuara.

Në Kosovë, nëpër ministri dhe komuna, ka një numër të zyrtarëve të barazisë gjinore¹⁸, mirëpo rolet e tyre mbeten të marginalizuara apo përfshihen rrallë në planifi im, buxhetim, vlerësim të ndikimeve apo analizë të ligjeve apo kornizave të politikave. Poashtu, gjatë vëties së përparësive së Kosovës, OSHC-të e grave rrallë konsultohen nga palët Kosovare dhe ndërkombëtare të interesit.

Është e natyrshme se mungesa e kontakteve dhe e zërit të grave, shpie në mbështetje të ulët financiare për çështjet gjinore nga ana e institucioneve. Kjo vështirësitet edhe mëtej nga sfidat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, korruptionin në sektorët publikë dhe privatë, zbatimin e dobët të vendimeve gjyqësore, të kontratave dhe të ligjeve, duke përfshirë këtu edhe dëmshpërblimet për shkeljet e të drejtave të viktimateve siç është diskriminimi *de facto* kundër grave.

Për këtë, gratë në Kosovë zakonisht kanë qasje më të ulët në drejtësi, në realizimin e dëmshpërblimeve të garantuara me ligj dhe në kompnezim për krimet e përjetuara. Situata është e ngjashme edhe për personat lezbikë, homoseksualë, biseksulë dhe transgjinorë (LGBT), të cilët përballen me diskriminim në të gjitha nivelet e shoqërisë: në shoqëri, familje dhe mirëqenie. Për më tepër, personat me aftësi të kufizuar, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianë (posaçërisht gratë) përballen me një shkelje të ndryshme të të drejtave.

Sundimi i dobët i ligjit në Kosovë kombinohet me zakontat dhe traditat tradicionale ekzistuese. Gratë janë të nën-përfaqësuara në aspektin sasior dhe cilësor në proceset vendim-marrëse të të gjitha niveleve. Platformat gjinore të partive politike mbeten të dobëta dhe në disa raste nuk ekzistojnë fare. Proseset gjithëpërfshirëse për pjesëmarrje e të dyja gjinive rrallë merren parasysh. Gjithashtu, përparësitë infrastrukturore të Kosovës në disa rast nuk shërbejnë për një qasje në shërbime publike cilësore, posaçërisht për gratë.

17 Përkundër vështirësive të shumta gjatë decadas së fundit, Kosova ia ka dale të krijojë një infrastukturë të qëndrueshme ligjore dhe mekanizma institucionalë përritjen e barazisë gjinore me Programin për Kosovë dhe Agjencinë për barazi gjinore si instrumentet më të rëndësishme në këtë drejtim. Një fushë e rëndësishme është platforma e fuqishme institucionale e krijuar për të reaguar ndaj dhunës kundër grave, duke përfshirë krijimin e njësive hetimore të veçanta në kuadër të Policisë së Kosovës për mbrojtjen e viktimateve të dhunës familjare dhe trafikimit me qenie njerëzore. [Raporti për gjendjen e implementimit të RKSOKB 1325 në Ballkanin Perëndimor. (2013) Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Vëllimi: Dosjetë Helsinki nr.31], f. 19-20.

18 Zyrtarët për barazi gjinore në kuadër të ministrive dhe komunave janë përgjegjës përfundimtare të barazisë gjinore brenda ministrive dhe komunave. Burrat janë të nënpërfaqësuar në këto pozita ("Profili gjinor i Kosovës". (2014) Orgut, f. 6].

Përveç dhunës gjinore të ushtruar gjatë luftës dhe ndikimit të saj, në Kosovë janë të pranishme edhe forma të tjera të dhunës në baza gjinore. Platforma ligjore e Kosovës në lidhje me dhunën në baza gjinore është mjaftë gjithëpërfshirëse, ndërsa edhe bashkërendimi ndërmjet institucioneve është përmirësuar gjatë viteve të fundit, duke përfshirë emërimin e koordinatorit kombëtar. Sfidat e realizimit ndërlidhen me qasjen në drejtësi, rehabilitimin dhe riintegrin. Institucionet, palët ndërkombëtare të interesit dhe OSHC-të kanë ndërmarrë masa parandaluese, duke përfshirë strategjitet e punës me burra e djem për ndryshimin e roleve gjinore. Dhuna nga armët dhe vetëvrasjet prekin më tepër burrat se gratë. Ndërkaq është e përhapur edhe dhuna shtëpiake ndaj grave.

Papunësia¹⁹ në Kosovë është e lartë dhe gratë e angazhuara në fuqinë punëtore rrallë ngriten në pozita menaxhuese apo udhëheqëse. Gjithashtu, gratë janë udhëheqëse apo pronare të më pak se 10 përqind të bizneseve.²⁰ Vetëm 8 përqind e grave janë pronare të tokave, ndërsa 30 përqind e gjithë popullsisë së Kosovës jeton nën nivelin e varfërisë dhe 10 përqind në varfëri ekstreme.²¹

4. Çështja gjinore në planifikimin e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike

Nevojitet realizimi i një analize gjinore të cenueshmërive ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike në Kosovë. Megjithatë, Kosova ka ndërmarrë hapa për zhvillimin e projekteve që ndërlidhin ZRRF dhe NK, duke përfshirë aspektet që ndërlidhen me legjislacionin vetëdijesues gjinor, përfaqësimin gjinor, sistemimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe me buxhetimin në baza gjinore dhe mekanizmat financues [shih dokumentin e KDRRI].²²

“Iniciativa për Zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë(KDRRI)” u hartua nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me UNDP-në (krahas një numër palë të interesit të tjerë të Kosovës). Dokumenti shtjellon fazën fillestare të programit KDRRI (2012-2015),²³ të përqendruar në mbështetjen e mbështetjes së tre përparësive të Kornizës së veprimit të Hyogos (KVH)²⁴ në Kosovë.²⁵ Dokumenti i projektit trajton çështjet gjinore, siç u shpjeguan më lart, duke u përqendruar në identifikimin e mangësive ekzistuese dhe mënyrave të mundshme për trajtimin e tyre.

19 Rreth 18 përqind e grave/55 përqind e burrave që punojnë në tregun zyrtar të punës [Shih Orgut Consulting (2014) “Profili gjinor i Kosovës – Analiza e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet”].

20 Sipas raportimeve, Ministria e punës dhe mirëqenies sociale nuk ka një plan punësimi të vlefshëm, ndërsa Plani i fuqizimit ekonomik të grave për 2011-2013 nuk ka rezultate të dukshme për shkak të fondeve të pamjaftueshme. [Shih Orgut Consulting (2014) “Profili gjinor i Kosovës – Analiza e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet”].

21 Rreth 38 përqind e ekonomive shtëpiake të udhëhequra nga grata dhe 65 përqind e burrave dhe grave që jetojnë nëpër fshatra janë më të ndikuarit. [Refer, Orgut Consulting (2014) “Profili gjinor i Kosovës – Analiza e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet”].

22 UNDP (2013) “Nisma për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në Kosovë (KDRRI)”.

23 KDRRI synon rritjen e kapacitetit të qeverisë dhe shoqërisë të Kosovës për t'u përgatitur, reaguar, parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë natyrore. Dokumenti i projektit jep rezultatet e Vlerësimtit të nevojave të ZRRF nga IPA (të realizuar më 2010), Dialogut të politikave kombëtare që përfshiu një numrë hisedarësh në ZRRF, si dhe vlerësimit të kapaciteteve të bërë më 2011 nga Nisma e kapacitetit për zvogëlim të fatkeqësive (CADRI).

24 Korniza e veprimit e Hyogos (KVH) është plan 10 vjeçar për ta bërë botën më të sigurt nga rreziqet natyrore. KVH përvijon pesë përparësi veprimi, si dhe ofron parime udhëheqëse dhe mjete praktike për të rritur aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. Synimi i saj është të zvogëlojë humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë në mënyrë të qëndrueshme deri më 2015 duke rritur aftësinë ripërtëritëse të kombeve dhe bashkësive. Kjo nënkupton uljen e humbjeve të jetës, si dhe të pasurive shoqërore, ekonomike dhe mjesitore kur godasin rreziqet. Shih <http://www.unisdr.org/we/coordinate/hfa> [së fundmi e lexuar më 25 tetor 2014].

25 CADRI është nismë e Zyrës për parandalim dhe përballim të krizave të Programit zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP/BCPR), Zyrës së Kombeve të Bashkuara për bashkërendim të punëve humanitare (OCHA) dhe sekretariatit të Strategjisë ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për zvogëlim të fatkeqësive (Sekretariati i UNISDR). Misioni i saj është të rritë përpjekjet aktuale për zhvillimin e kapaciteteve të qëndrueshme botërore për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë. <http://www.cadri.net/>

Dokumenti i projektit është i përshtatshëm dhe i dizajnuar mirë sipas gjithë qëllimeve dhe synimeve; megjithatë, sipas përgjigjeve të dhëna nga respondentët në kohën e këshillimit, është e qartë se asnë prej dispozitave që ndërlidhen me gjininë ende nuk është filluar apo realizuar,²⁶ duke përfshirë:

- y Realizimin e një analize gjinore dhe bazuar në rezultatet e saj të ndërmirret planifikimi dhe realizimi i zhvillimit të kapaciteteve dhe vetëdijesimit rreth çështjeve gjinore për homologët e Kosovës.
- y Përcaktimi i dispozitave për grupet shoqërore të ceneshe në ligje në strategjinë e ZRRF të Kosovës dhe në planet zhvillimore, aty ku është e përshtatshme dhe efektive.
- y Ndarja e të dhënave dhe analiza për vlerësimet e rreziqeve të ndërmarra për ceneshmëri dhe kapacitete të veçanta shoqërore të të gjitha grupeve shoqërore, duke përfshirë gratë, burrat, fëmijët, të moshuarit, etj.
- y Sigurimi i përfaqësimit të mjaftueshëm të grave dhe grupeve të tjera të ceneshe shoqërore në të gjitha proceset dhe veprimet vendim-marrëse. Përqindja e femrave përfituese nga komponenta e menaxhimit të ndryshimeve klimatike në nivel lokal do të pasqyrojë përpjesën e popullsisë femrave së bashkësive individuale në shenjestër.
- y Për veprimet kombëtare gjithëpërfshirëse (si zhvillimi i strategjive dhe instituioneve, si dhe vlerësimi i rrezikut), KDRRI do të zbatojë një qasje shumë-faktorëshe të rrezikut. Sa u përket veprimeve lokale, KDRRI do të përqendrohet në rreziqe specifike që paraqesin rrezikun më të madh ndaj bashkësive. Përdorimi i të dhënave të papërpunuara mundëson prioritizimin e mëposhtëm të rreziqeve për përzgjedhjen e bashkësive për këto veprime: 1) Përblytjet, 2) Thatësitrat, 3) Tërmetet, 4) Kafshët e egra, 5) Të reshurat e mëdha të botës dhe orteqet; dhe 6) Rrëshqitjet e dheut.

Kornizat ligjore dhe të politikave në Kosovë përqendrohen më shumë në reagim se në përgatitje. Megjithëse ekzistojnë dy institucione kryesuese për ZRRF (Agjencia për menaxhimin e emergjencave dhe Qendra e situatave), detyrat dhe autoriteti i këtyre të dyave kryqëzohen ose nuk janë shumë të qarta, gjë që pengon bashkërendimin ndërmjet tyre. Nevojitet përmirësimi i bashkërendimit horizontal dhe vertikal, si dhe mbështetja e kapaciteteve themelore financiare dhe të burimeve njerëzore. Mundësia për prezantimin e qasjes gjithëpërfshirëse ndaj ZRRF është e vazhdueshme dhe përfshin shqyrtimin dhe rishikimin e shumicës së akteve ligjore kryesore rreth ZRRF. Parashihet që procesi i rishqyrtimit (bashkë me studimet ekzistuese dhe rezultatet e vlerësimeve të rrezikut) do të ofrojë bazën analitike për propozimin e amandamenteve të nevojshme në kornizën ligjore dhe rregullatore, miratimin e strategjisë së Kosovës të ZRRF, përgatitjen e platformës kombëtare, si dhe për krijimin e mekanizmit të qëndrueshëm të financimit të ZRRF.

Proceseve aktuale të vlerësimit të rrezikut mungojnë masat e qëndrueshme institucionale, si dhe metodat dhe mjetet e standardizuara për mbledhjen, menaxhimin e analizën e të dhënave. Gjithashtu, kamungesë të personelit dhe pajisjeve, edhe për analizat e të dhënave të përfshira nga sistemet monitoruese ekzistuese. Vlerësimi i rrezikut është përqendruar në analizën e rreziqeve dhe nuk e përfshin siç duhet vlerësimin e ceneshmërisë dhe kapacitetit. Të dhënat aktualisht përdoren për paralajmërim të hershëm dhe reagim të shpejtë ndaj fatkeqësive. Ndërlidhja ndërmjet organeve për monitorim dhe menaxhim emergjencash kërkon specifikim dhe fuqizim zyrtar. Ekzistojnë zyra komunale që merren specifisht me menaxhimin e emergjencave; ato përqendrohen në përgatitje dhe reagim, mirépo u mungojnë burimet e duhura.

26 Në fakt, ky këshillim mund të përfaqësojë përbushjen e një aspekti të saj.

(a) Vrojtimet e palëve të interesit

Konsulenca për rishikimin e përfaqësimit gjinor, shtator-tetor 2014, e mbajtur me qëllim të hartimit të rekomandimeve (këtij raporti), identifikoi qartë shtatë çështje kryesore për përbushjen e nevojave gjinore për planifikimin e përballimit të ZRRF dhe ndryshimeve klimatike (NK) për Kosovë [shih tabelën 1 më poshtë].

tabela: çështjet e interesit e interesit nga palët e interesit

Çështjet e përcaktuara nga palët e interesit		numri i mendimeve	Përqindja e mendimeve
(i)	Legislacioni i barazisë gjinore	12	92%
(ii)	Zhvillimi i kapaciteteve Në institucionet e Kosovës, OJQ dhe bashkësi lokale	13	100%
(iii)	Pjesëmarrja në zhvillimin e strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (PNK)/përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike (PNK)	0	0%
(iv)	Pjesëmarrja në zhvillimin e strategjisë për Zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitetë (ZRRF)	7	54%
	Institucionet e K+ OJQ+niveli lokal	2	15%
(v)	Partneritetet dhe bashkërendimi në realizimin e strategjisë gjinore	<p>Institucionet e K+KB</p> <p>Institucionet e K</p>	<p>31%</p> <p>31%</p>
	S'ka bashkërendim	3	23%
	PNK	S'ka buxhet të specifikuar	?
(vi)	Mbështetja financiare dhe ndarja e buxhetit	<p>ZRRF</p> <p>Gjinia</p>	<p>S'ka buxhet të specifikuar</p> <p>S'ka buxhet të specifikuar</p>
	I fuqishëm	1	7 %
(vii)	Bashkërendimi dhe rrjetëzimi	<p>I mirë, por mund të fuqizohet</p> <p>I dobët</p>	<p>23%</p> <p>31%</p>
	S'ka bashkërendim	5	39%

Tabela e mësipërme ilustron rezultatet e intervistave me 13 palë të interesit, si më poshtë:

SHENJË I PAGËS

Agjencia për barazi gjinore nuk u përfshi, as nuk mori pjesë gjatë hartimit të strategjisë për ndryshime klimatike të Kosovës.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, “përbërja e Kuvendit të Kosovës do të jetë në harmoni me parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.”

sipas ligjit për barazi gjinore të Kosovës [ligji nr. 2004/2], kapitulli 4, nenı 4.16,

“[...]Vendimet që marrin autoritete lokale, para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore edhe nga zyrtari/zyrtarja për barazi gjinore në komunën përkatëse.”

Kapitulli 5, nenı 5.2(b),

“I propozon autoriteve te nivelit qëndror dhe ministrive hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe miratimin e masave të tjera.”

(i) barazia gjinore dhe ligjet:

92% e respondentëve theksuan qartësinë e Ligjit për barazi gjinore të Kosovës dhe ndërlidhjen e tij me ligjet në fuqi, duke përfshirë ligjet përmendësuar mbrojtjen e pasurisë dhe trashëgimisë kulturore, si dhe ato mbi trashëgiminë dhe pronësinë, ku është përfshirë trajtimi i çështjes gjinore. Megjithatë, të gjithë respondentët përmendën që, megjithëse Ligji për barazi gjinore mbulon të gjitha fushat e nevojshme, mungon mekanizmi përmendësuar që realizim të tyre ose procesi i praktikueshëm i përfaqësimit në kornizën me të gjérë legjislative të Kosovës.

(ii) zhvillimi i kapacitetit dhe institucioneve:

Të gjithë palët e interesit përmendën rëndësinë e vetëdijësimit më të madh rreth përfaqësimit të barabartë gjinor dhe nevojës për zhvillimin e kapaciteteve sipas Ligjit për barazi gjinore. Për më tepër, të gjithë respondentët nxorën në pah se barazia gjinore ende nuk është përfshirë në planet e ZRRF dhe PNK, si dhe që nevojitet përfshirja e personelit të institucioneve të Kosovës, zyra e barazisë gjinore (nëpër komuna), OJQ-ve, komunave dhe bashkësive lokale.

“[...] Në nivel lokal, gratë nuk e kuptojnë që kanë të drejtë dhe duhet të marrin pjesë njëjtësisht burrat e tyre. Atomendojnë që, edhe nëse e punojnë tokën, nuk bën ta regjistrojnë atë në emër të vet, por e regjistrojnë në emër të burrave, edhe nëse këta jetojnë jashtë Kosovës apo nuk marrin fare pjesë në veprimtarinë bujqësore.”

respondente femër

Në këtë kuptim, respondentët këshilluan se nevojitet vetëdijësim dhe zhvillim i kapaciteteve në nivel ndër-sektorial dhe shumë-sektorial përmendësuar që gjithë partnerët dhe target grupet e ZRRF dhe PNK. Gjithashtu është vënë në pah që kishte një keqkuptim të vazhdueshëm të koncepteve “**gjini**” dhe “**përfaqësim i barabartë gjinor**”, gjë që bënte që ato të mos përfshiheshin fare në proceset planifikuese apo përfshiheshin në mënyrë joefektive. Shumë prej respondentëve thanë që legjislacioni dhe strategjia për barazi gjinore obligojnë përfshirjen e nevojave të burrave, grave, djemve, vajzave e bashkësisë LGBT në strategjitet përmendësuar që ZRRF dhe PNK.

siç tha një respondent mashkull, "numri i grave që aplikojnë në poste të larta është tejet i vogël, gratë zakonisht i gjenë në poste më të ulëta. Mirëpo, ligji parasheh që 40% e personelit të janë femra (ligji për barazi gjinore)".

(iii),(iv),(v) & (vi). Pjesëmarrja, zhvillimi i PNK dhe ~~zgjedhje~~ si dhe partneritetet dhe bashkërendimi gjithëpërfshirës:²⁷

Të anketuarit pohuan që nuk ka pasur një përfaqësues të veçantë për çështje gjinore të caktuar nga grupei punues. Ngjashëm, gjatë hartimit të Strategjisë për ZRRF, dhe organizatat janë ndjerë të përjashtuara apo nuk janë konsultuar siç duhet. Të anketuarit pajtoheshin për nevojën e papërm bushur të përfshirjes së çështjen gjinore në strategjitet e PNK dhe ZRRF, në proceset e planifikimit, në planet e realizimit, si dhe në proceset dhe mekanizmat monitorues dhe vlerësues.

Të anketuarit nga UN-Habitat dhe FAO thane që ata "kishin mbështetur dy trajnime të mëhershme përfshirjen e çështjes gjinore në pylltari dhe planifikim hapësinor, mirëpo ato nuk ishin të ndërlidhura, prandaj rrezikohej përsëritja, shpenzimi kotë dhe mungesa e gjithëpërfshirjes."

Në përgjithësi, të anketuarit (31%) janë pajtuar që bashkërendimi dhe rrjetëzimi gjinor aktual ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara është i pamjaftueshëm si dhe bashkërendimi dhe konsultimet ndërmjet autoriteteteve të Kosovës, OJQ-ve dhe bashkësive lokale është tejet i ulët. Kjo dëshmon rëndësinë e fuqizimit të bashkërendimit dhe partneritetit në nivel vertikal dhe horizontal sa i përketë çështjes gjinore duke përfshirë nivele të ndryshme (institucionet e Kosovës, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, OJQ-të dhe bashkësítë lokale). Kjo do të minimizonte kryqëzimin dhe përsëritjen e veprimtarive, duke nxitur njëkohësisht një qasje të integruar ndaj përfaqësimit të barabartë gjinor në të gjitha programet mjedisore të Kosovës.

SHENJË TË PËRGJIGJVE

"Institucionet e Kosovës dhe OJQ-të kanë nisur diskutimin përvzhvillimin e një strategjie bashkërenduese me OJQ, pasiqë të parat nuk kanë mekanizma bashkërendues me OJQ-të. Brengë ime është tani në Kosovë ka shumë strategji, mirëpo mungon ndërlidhja ndërmjet këtyre strategjive."

Përfaqësuese e ojQ-së

"Përfaqësimi i barabartë gjinor kërkon bashkërendim dhe bashkëpunim vertical dhe horizontal ndërmjet vendimarrësve, OJQ-ve dhe bashkësive lokale, duke përfshirë burrat, grata, djemtë, vajzat dhe grupet e marginalizuara."

studentë universiteti

(vii) Mbështetja financiare dhe financimi:

Të gjithë të anketuarit u pajtuan që ka mungesë fondesh për përfaqësim të barabartë gjinor në të gjithë sektorët, duke përfshirë ZRRF dhe PNK. Ata gjithashtu thanë që nuk kishin të dhëna se ku mund të merrnin fonde shtesë dhe kujt t'i drejtohen për një gjë të tillë.

27 Çështjet 3, 4, 5 dhe 6 trajtohen si një temë në kuadër të bashkërendimit dhe partneritetit, pasiqë disa të intervistuar e kishin të vështirë të kuptonin dallimin ndërmjet bashkërendimit, pjesëmarrjes, partneritetit, advokimit dhe rrjetëzimit. Prandaj, këshilltarja përdori metoda të ndryshme përmarrë përgjigjen e duhur gjatë intervistave.

Të anketuarit u pajtuan që është i nevojshëm formimi i një komitetit bashkërendues efektiv dhe hartimi i një plani të veprimit ndërmjet agjencive të Kombeve të Bashkuara, institucioneve të Kosovës, Agjencisë për barazi gjinore nën udhëheqjen e kryeministrit dhe OJQ-ve vendore, me qëllim të realizimit të një plani të përbashkët të veprimit dhe të veprimtarive të përbashkëta.

Zyrtari/ja për barazi gjinore i Agjencisë për barazi gjinore:

“Zyrtari/ja për barazi duhet të bëjë kërkesë për fonde për secilën veprimtari, meqë nuk ka kategori specifike buxhetore për veprimtari të barazisë gjinore.”

IV. PërfurDIME

Rezultatet e **Konsulencës për rishikimin e përfaqësimit gjinor, shtator-tetor 2014**, nxorën në pah nevojën për zhvillimin e katër fushave në Kosovë me qëllim të arritjes së një qasjeje që merr parasysh çështjen gjinore ndaj ZRRF dhe PNK. Është e qartë që Kosova e ka legjislacionin dhe bazamentin e nevojshëm, që mundësojnë punën e mëtejme për të garantuar reagim efektiv dhe gjithëpërfshirës ndaj ZRRF dhe PNK. Ajo që mungon, sipas palëve të interesit të anketuar, ka të bëjë me burimet administrative, menaxhuese dhe njerëzore (duke përfshirë financimin). Këto mungesa kanë dërguar në shtyrjen e realizimit të rezultateve të përvjuar në KDRRI-në e Kosovës.


Në këtë drejtim, për të zhvilluar këto aspekte në mënyrë efektive dhe praktike, Kosovës i duhet një **organ/komitet harmonizimi**, një **shqyrtim** i hollësishëm i mangësive dhe ndikimit të **ligjeve dhe legjislacionit ekzistues, përkrahje financiare** (për momentin Kosova ndan 15% të buxhetit të ZRRF për veprime gjinore, por a mjafton kjo? Si u llogarit kjo shifër dhe a kontribuoi ABGJ në përllogaritjen e kësaj shifre?)²⁸ dhe, në fund, **zhvillimi i kapaciteteve**.

Kjo e fundit është e domosdoshme për të gjitha fushat. Gjatë ditës së parë të punëtorisë, pjesëmarrësit dëshmuant që nuk e kuptionin nevojën për strategji të ndjeshmërisë gjinore në lidhje me Përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe ZRRF. Mungesa e njohurive, të të kuptuarit dhe vendosjes së përparësive sa i përket nevojës për përfaqësim gjinor pengon aftësinë e Kosovës për bashkërendim të suksesshëm, për analiza gjinore dhe për të garantuar mbështetjen e nevojshme financiare.

Si irredhojë, organizatat, institucionet dhe anëtarët e bashkësive të ngarkuar me përfshirjen e aspektit gjinor në strategjitë e ZRRF dhe PNK të Kosovës duhet të punojnë bashkë me Agjencinë për barazi gjinore të Kosovës në një marrëdhënie reciproke përkrahëse.

V. REKOMANDIMET RAN I VERRIT

Në këtë pjesë të të raportit janë dhënë rekomandimet dhe një plan veprimi të nivelit makro, për një periudhë 2.5 vjeçar (me 3 fazë), përtë nxjerrë në pah fushat e nevojshme, përtë zhvilluar dhe përbushur rezultatet e përcaktuara me KDRRI-në e Kosovës gjatë një periudhe dyvjeçare, me një periudhë përfundimtare gjashtë mujore të ndarë për procesin e shqyrtimit dhe përshtatjes së planit të veprimit për përbushje të objektivave gjinore të KDRRI-së.



Diagrami (2): shtrirja kohore e intervenimeve të mundshme të planit të veprimit

A) bashkërendimi

Shtrirja kohore e planit të veprimit

Faza 1 – Viti 1 (12 muaj)

Çështja gjinore dhe ZRRF/NK janë çështje zhvillimore gjithëpërfshirëse. Për trajtimin e tyre nevojitet një qasje holistike me shumë palë të interesit, si dhe veprime të bashkërenduara që bazohen në procese politike, teknike, shoqërore, zhvillimore dhe humanitare.

Përfaqësimi i barabartë gjinore në ZRRF/PNK ofron një mundësi për rishqyrtimin e raporteve gjinore në shoqërinë kosovare nga këndvështrime të ndryshme, si dhe përritjen e barazisë gjinore në zhvillimin shoqëror-ekonomik. Ai gjithashtu u mundeson bashkësive në Kosovë të zhvillojnë aftësinë ripërtëritëse prej fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike. Ky është një rast i mirë që qeveria dhe organizatat vendore të arrijnë zhvillimin e qëndrueshëm duke punuar bashkë në një mënyrë të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të bashkënduar.

Faza 1a, 6 muajt e parë:

- Themelimi i një komiteti përmes Agjencisë për barazi gjinore – krijimi i bazës për pasurimin e platformës kombëtare të ZRRF.
- Dizajnimi i strukturës së komitetit dhe orientimi te ministritë përkatëse.
- Inicimi i zhvillimit të kapaciteteve të anëtarëve të komitetit.
- Ndërlidhja e punës së komitetit me komponentën gjinore të KDRRI-së.

Faza 1b, 6 muajt vijues:

- Buxheti për themelimin e komitetit dhe administrimin.
- Zhvillimi i proceseve të brendshme të komitetit për të garantuar struktura vendimmarrëse gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse.
- Definimi i angazhimit të komitetit me ministritë përkatë dhe kontributit në mekanizmat e reagimit të shpejtë, proceset legislative, etj.
- Krijimi i një databaze për të dhëna rreth ZRRF dhe PNK të ndara sipas gjinisë, moshës, gjendjes minoritare, etj.

Rekomandimet e palëve të interesit:

- Bashkëpunimi ndër-institucional është me rëndësi parësore në nivelin qendor dhe lokal. Mirëpo bashkëpunimi me bashkësitë duhet të përfshijë rrjetet e grave.
- Nevojitet bashkërendim më i efektiv ndërmjet OJQ-ve të nivelit kombëtar dhe lokal.
- Duhet t'i kushtohet vëmendje zhvillimit të bashkëpunimit ndër-sektorial, duke përfshirë çështjen gjinore si qasje gjithëpërfshirëse.
- Duhet të rritet numri i grave të përfshira në pozita vendimmarrëse.
- Bashkërendimi është i dobët dhe sjell pasoja të konsiderueshme negative, prandaj duhet të mbahen mbledhje të rregullta përfshirë bashkërendimin.
- Nevojitet integrim më i mirë i sistemeve përfshirë menaxhuan emergjencat me sukses; rolet e organizatave duhet të përkufizohen dhe të përshtaten veprimtaritë e nevojshme.
- Do të ishte mirë që Ministria e Punëve të Brendshme të organizonte trajnime gjinore rreth ligjeve përfshirë mbrojtjen e burimeve natyrore dhe mjesidore (përballim të fatkeqësive natyrore dhe zjarreve) me ministritë përkatëse në nivel qëndror dhe lokal, pasiqë gratë kanë munguar apo janë përjashtuar deri më tanë.
- Të gjitha institucionet e Kosovës duhet të përfshihen në menaxhimin e emergjencave, si dhe duhet të themelojnë një grup punues apo komitet përfshirje gjinore.

- Mbledhjet bashkërenduese duhet të mbahen sipas një plani të veprimit, bazuar në nevoja. Për të pasur bashkërendim të vazhdueshëm, është i domosdoshëm bashkëpunimi me Ministrinë e Financave.
- Nevojitet një plan veprimi që përkufizon vendin dhe kohën e takimeve në mënyrë proaktive, jo vetëm reaguese.
- Komiteti ose grupi punues duhet të takohet çdo tre muaj, dhe duhet të përfshijë organet me rëndësi parësore profesionale dhe shoqërinë civile.
- Takimet e komitetit dhe grupeve punues duhet të janë gjithëpërfshirëse me të gjitha grupet profesionale, dhe të diskutojë çështjet gjinore me pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe të gjithë aktarët që kanë potencialin për të reaguar apo për të ofruar të dhëna.
- Përfshirja gjinore, pjesëmarrja dhe ndryshimi i qëndrueshëm nuk janë të mundura pa bashkërendim dhe bashkëpunim të fuqishëm të komitetit të palëve të interesit nga nivele të ndryshme të përqendruar në ZRRF dhe PNK.
- Ministri i punëve të brendshme, Agjencia për barazi gjinore dhe Ministri i mjedisit dhe planifikimit hapësinor duhet të dakordohen për një zyrtar/e për barazi gjinore të një komitetit Kosovar, që do të bashkërendonte jetësimin e rekomandimeve dhe të planit të veprimit.
- KDRRI-ja e UNDP-së dhe komponenta gjinore e UNDP-së mund t'i jepin mbështetje shtesë komitetit.
- Komiteti bashkërendues duhet të përfshijë institucione qeveritare dhe joqeveritare, sektorin privat dhe bashkësi lokale.



Diagrami (3): Dizajni dhe marrëdhëniet e mundshme të komitetit kosovar për përfshirje të gjinisë në ZRRF dhe PNK

Sic shihet në strukturën e paraqitur më lart, Komiteti kosovar për përfshirje të gjinisë në PNK dhe ZRRF duhet të përbëhet nga zyrtarë/e për barazi gjinore nga institucionet që përkatëse të Kosovës (të nivelit qendror dhe komunal), nga punonjës të OJQ-ve vendore dhe përfaqësues të bashkësive vendore kur është e mundur. Ai duhet të jetë gjysmë i pavarur me planin e veprimit dhe buxhetin e vet, të paktën derisa të finalizohen aspektet gjinore të KDRRI-së, mirëpo do t'u raportojnë ministritëve përkatëse të angazhuara me barazi gjinore, ZRRF dhe PNK.

Komiteti duhet të udhëhiqet nga Agjencia për barazi gjinore (ABGj e angazhuar për barazi gjinore), Ministria e brendshme (MPB e angazhuar për ZRRF) dhe Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor (MMPH merret me PNK), ndërsa agjencitë e Kombeve të Bashkuara do të kenë rol këshillues, teknik dhe mbështetës (p.sh., KDRRI-ja e UNDP-së. etj.). Marrëdhëniet e treguara me anë të shigjetave në diagram tregojnë mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme, OJQ-ve dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara. Shumica e marrëdhënieve janë dy-drejtëmëshe, gjë që tregon rrjedhën e të dhënavëve, si dhe proceset gjithëpërfshirëse dhe rrjetëzimin. Në këtë drejtim, agjencitë e Kombeve të Bashkuara duhet të punojnë bashkë me të gjitha institucionet për të përkrahur një qasje të tillë dhe për të ofruar mbështetjen e nevojshme.



Dy grupe punuese duke diskutuar rekondimet për përfshirjen e çështjes gjinore në ~~zgjedhje~~ PnK gjatë punëtorisë dy-ditore të mbajtur në Prishtinë, Kosovë gjatë tetorit të 2014-ës

b) gjinia, ligjet dhe politikat	Shtrirja kohore e planit të veprimit
<p>Është shënuar përparim i dukshëm në ZRRF/NK në nivel qëndror, mirëpo perspektiva e përfaqësimit të barabartë gjinor mbetet marginale. Kjo ndodh në masë të madhe për shkak të të kuptuarit të dobët të ndërlidhjes ndërmjet gjinisë dhe ZRRF/NK. Njohja më e madhe e kësaj ndërlidhjeje është jetike në nivel qëndror, ku politikat, ligjet dhe vendimet e duhura mund të kenë ndikim të madh në trajtimin e cenueshmërive dhe rreziqeve nga fatkeqësítë të grave dhe burrave. Në Kosovë ende nuk është bërë analiza e thellë e cenueshmërive me baza gjinore. Megjithëkëtë, ligjvënësit dhe hartuesit e politikave duhet të jenë të përgjegjshëm ndaj përparimit në lidhje me përfaqësimin e barabartë gjinor në ZRRF/NK.</p> <p>Në këtë drejtim, në Kosovë duhet të hartohen dhe shqyrtohen politika kombëtare, ligje përkatëse, strategji, plane dhe të ndahet buxheti i nevojshëm. Gjithashtu, duhet të ndërmerren masa të menjëhershme përgarantimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në politikat, planet dhe programet zhvillimore kombëtare.</p>	<p>Shtrirja kohore e planit të veprimit</p> <p>Faza 2 – Viti 2 (12 muaj)</p> <p>Faza 2a, 6 muajt e parë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të bëhet analiza gjinore dhe anketimi i Kosovës mbi cenueshmëritë dhe rreziqet me bazë gjinore nga fatkeqësítë dhe ndryshimet klimatike. Të përcaktohen dispozitat për grupet e cenueshme shoqërore në ligje, në strategjitet e Kosovës të ZRRF the PNK, si dhe planet zhvillimore, kur është e mundur dhe efektive. Të nisë sistematizimi i të dhënave të ndara. <p>Faza 2b, 6 muajt vijues:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të publikohen mësimet e marra nga analiza gjinore dhe anketimi, pastaj, bazuar në rezultatatet e tyre, të përgatitet dhe realizohet zhvillimi i kapaciteteve dhe vetëdijesimi rrëth çështjeve gjinore për homologët Kosovarë. Të lehtësohen përpjekjet e Kosovës përvakim dhe komunkim në lidhje me ZRRF dhe PNK që marrin parasysh çështjen gjinore përmes Agjencisë për barazi gjinore.
<p><u>Rekomandime të palëve të interesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Politikat e barazisë gjinore duhet të përfshihen edhe në nivelet lokal, jo vetëm në Prishtinë/Priština. Duhet të ketë hapësirë përditore publike rrëth strategjive ekzistuese dhe të mundshme për ZRRF dhe PNK, pra të garantohet që strategjitet kornizë të jenë të hapura përdor publikun në uebfaqe të autoriteteve Kosovare, përdor të mundësuar përfshirjen dhe rekomandimet aktive, etj. Megjithatë, edhe pse përmomentin mendimet e shoqërisë civile janë të mirëseardhura, mungojnë fondet përfincimin e tyre. Korniza ligjore përgjini dhe ZRRF duhet të rishqyrtohet pasiqë: <ul style="list-style-type: none"> Gratë nuk janë pyetur fare përdor strategjitet/planet; Çështjet gjinore nuk janë pasqyruar mjaftueshëm; Mbetet problem monitorimi i strategjive/politikave; Deri më tanë, ka munguar pjesëmarrja kuptimplotë e shoqërisë civile (janë përfshirë vetëm 2-3 organizata, që të gjitha me bazë në Prishtinë); Gratë nuk përfaqësohen siç duhet në institucionet vendimmarrëse. 	

- Institucionet me rëndësi parësore që duhet të përfshihen janë:
 - Zyra e kryeministrat, përgjegjëse për ligjet dhe politikat;
 - Zyrat për barazi gjinore në ministritë përkatëse;
 - Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor;
 - Agjencia për menaxhimin e emergjencave (AME);
 - Zyra për çështje gjinore në nivel të bashkësisë; dhe
 - Gratë e shoqërisë civile dhe organizatat e bashkësisë LGBT apo të grupeve të tjera të marginalizuara ose të cenueshme.
- Çështjet dhe mangësitë kryesore:
 - Strategjia dhe plani i veprimit për çështjet gjinore në përgjithësi – për të garantuar realizimin e komponentës gjinore të KDRRI-së;
 - Programet e posaçme parandaluese për ZRRF/PNK për gratë;
 - Prioritizimi dhe përkrahja e rolit të zyrtarëve/eve për barazi gjinore – nevojitet zhvillim i kapacitetit dhe financimi;
 - Bashkërendimi efektiv me shoqërinë civile – në nivel lokal dhe qëndror;
 - Organi/komiteti efektiv me përgjegjësi realizuese, që funksionon në kuadër të hierarkisë të institucioneve së Kosovës dhe që financohet siç duhet; dhe
 - Zyrtari/ja e detyrueshme për barazi gjinore në të gjitha ministritë, duke përfshirë nivelin e drejtive komunale.



Shtrirja kohore e planit të veprimit

Përkrahja e donatorëve ndërkombëtarë për aspektet e gjinisë dhe të ZRRF/NK është e pamjaftueshme. Përkrahja jepet kryesisht për projekte, gjë që pengon qëndrueshmërinë.

Kosova ka ndarë 15% të buxhetit të vet për ZRRF për veprimtari vetëdijësuese gjinore. Në këtë kuadër, institucionet financiare dhe mekanizmat financues që përkrahin masat e NK dhe ZRRF duhet:

- Të përfshijnë kritere të ndjeshme ndaj gjinisë në planifikimin, hartimin, realizimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve, projekteve dhe nismave;

Faza 2 – Viti 2 (12 muajt e dytë)

Faza 2a (6 muaj)

- Të krijohet buxheti afatgjatë për komitetin.
- Të gjenden burime financimi, duke përfshirë buxhetin e Kosovës.

- Të ndajnë burimet e nevojshme për trajtimin e nevojave të grave në përballjen e ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësita, për shembull duke financuar teknologji të përshtatshme dhe të sigurta mjedisore, si dhe duke përkrahur nismat e grave për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Të mos financojnë industritë gjermuese, si mihta, prerja e druve dhe nxjerra a naftës dhe gazit natyror, që kontribuojnë në ndryshimet klimatike, varférinë dhe pabarazinë gjinore.
- Mekanizmat e bazuar në treg, si Mekanizmi i zhvillimit të pastër (MZhP), Fondi i gjelbër dhe kreditë për ndryshime klimatike, duhet të jenë në dispozicion të grave e burrave, si dhe duhet të garantojnë përfitime të paanshme. Kështu, Fondi i gjelbër duhet të financojë projekte që synojnë rritjen e kapaciteteve përshtatëse lokale, sjellin zgjidhje të qëndrueshme, si dhe ofrojnë teknologjitet e përshtatshme për nevoja shtëpiake, veprimtari ekonomike dhe lëvizshmëri shoqërore-ekonomike të grave.

Faza 2b (6 muaj)

- Të aplikohet te financues dhe donatorë.
- Të bëhet ndërlidhja me Agjencinë e barazisë gjinore për të garantuar financim gjinor në strategjitet shtetërore të ZRRF dhe PNK.
- Të ndahen fonde të mjaftueshme për nismat e Kosovës të komunikimit dhe avokimit në lidhje me gjininë dhe ZRRF e PNK.

Rekomandime të palëve të interesit

- Fondet duhet të jepen nga autoritetet e Kosovës në Prishtinë/Priština por gjithashtu duhet të bashkëpunohet me OJQ vendore. Gjithashtu mund të aplikohet përfinancim të përbashkët nga USAID, GIZ, SIDA, JICA, agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe Banka Botërore. Financimi dypalësh është burim i rëndësishëm.
- Kosova është në proces të harmonizimit të legjisacionit me urdhëresat e BE-së, prandaj financimi duhet të jetë një proces paralel.
- Duhet të ndërmerren projekte të përbashkëta ndërmjet autoriteteve Kosovare, shoqërisë civile dhe bizneseve, për të përfshirë kështu edhe vendimmarrësit.
- Nuk ka dispozitë përfinancim të aspekteve gjinore në ZRRF/PNK në buxhetin trevjeçar të Kosovës.
- Duhet të mobilizohen burimet, por për këtë nevojitet bashkërendim i mirë. Buxhetimi dhe sigurimi i fonave duhet të përfshijë tregues që marrin parasysh çështjen gjinore.
- Fondet emergjente duhet të përfshijnë financimin e vlerësimeve të situatave emergjente, si dhe të proceseve të pas luftës e pas fatkeqësive, pasiqë për to nevojitet vlerësimi i ndikimit gjinor dhe të proceseve gjithëpërfshirëse.
- Duhet të ndërmerren hapa që marrin parasysh çështjen gjinore, me qëllim të uljes së ndjeshmërisë ndaj fatkeqësive natyrore dhe rreziqeve nga ndryshimet klimatike;

“në realitet, nuk kemi buxhet specifik për emergjencat. nuk jam i sigurt sa buxhet ka ndarë secila ministri përfshirje të çështjes gjinore në fatkeqësitet natyrore. Duhet të ketë një buxhet të veçantë në nivel qëndror përfshirje të çështjes gjinore në ~~zgjedhje~~ PnK, që të mbulohen komunat. sa i përket ~~zgjedhje~~ asnjëra prej komunave nuk ka buxhet specifik përfshirje të çështjes gjinore. Kjo duhet të shënohet dhe mund të bartet nga viti në vit, të mblidhet e të përdoret.”

- Ministria e mjedisit ka fonde të kufizuara, rreth 10 milionë. Në të ardhmen shpresohet që më shumë rëndësi t'u kushtohet çështjeve të ZRRF dhe PNK, ashtu që të ndahet një buxhet në vlerë prej 100 milionësh.
- Në buxhet duhet të merren parasysh shpenzimet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata. Për ta bërë këtë, duhet të identifikohet për çfarë ka nevojë dhe pastaj të kërkohet mbështetja. Për identifikimin e nevojave duhet të kuptohen rreziqet dhe cenueshmëritë; për këtë nevojiten hulumtime, ndërsa për realizim të hulumtimeve nevojiten fonde dhe burime shtesë.
- Për të ulur rreziqet, nevojitet financim për infrastrukturë konkrete dhe themelore, si sistemi i kanalizimit që nuk është i përfunduar as në Prishtinë.

D) zhvillimi i kapaciteteve

Ndryshimet mund të bëhen duke kuptuar përvojat e ndryshme, shkathtësitë dhe rolet e mundshme të burave dhe grave në ZRRF/NK. Për ta arritur këtë, zhvillimi i kapaciteteve, avokimi vetëdijesues dhe strategjitë/fushatat komunikuese/mediale mund të jenë shumë të suksesshme – zhvillimi dhe përmirësimi i kapacitetit të organizatave profesionale, bashkësive dhe institucioneve përkatëse qëndrore dhe lokale për të mundësuar përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjithë sektorët zhvillimorë. Në këtë drejtim, institucionet Kosovare duhet:

- Të përkrah, lehtësoj, zhvilloj dhe realizoj fushata të vetëdijesimit publik, si dhe programe arsimore dhe trajnuese rreth NK dhe ZRRF, duke përfaqësuar njëjtë burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat;
- Të lehtësoj qasjen në të dhëna rreth politikave dhe rezultateve të veprimeve mbi ndryshimet klimatike dhe uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë, të cilat burrat dhe gratë duhet t'i kuptojnë, trajtojnë dhe përfshijnë në kuadër të NK dhe ZRRF, duke marrë parasysh rrethanat lokale dhe qëndrore si cilësia e qasjes në internet apo çështjet e analfabetizmit apo të gjuhës; dhe
- Të evidentoj sistematikisht dhe t'i vë në dispozicion praktikat më të mira në lidhje me nismat e NK dhe ZRRF që marrin parasysh çështjen gjinore, duke mundësuar përsëritjen e këtyre praktikave.

Shtrirja kohore e planit të veprimit

Fazat 1, 2 dhe 3 (mbi 30 muaj):

Periudha e parë 12 mujore:

- Zhvillimi i kapaciteteve të anëtarëve të komitetit.

6 muajt e parë të periudhës së dytë 12 mujore:

- Të shqyrtohet përparimi në periudhën e parë 12 mujore. Të përshtaten synimet ku është e nevojshme, të përballohen problemet dhe të adaptohen proceset përfazës vijuese.

6 muajt e dytë të periudhës së dytë 12 mujore:

- Të publikohen mësimet e marra nga analiza gjinore dhe anketimi, pastaj, bazuar në rezultatet e tyre, të përgatitet dhe realizohet zhvillimi i kapaciteteve dhe vetëdijesimi rreth çështjeve gjinore përfshinë Kosovarë.
- Të lehtësohen përpjekjet e Kosovës për avokim dhe komunkim në lidhje me ZRRF dhe PNK që marrin parasysh çështjen gjinore përmes Agjencisë për barazi gjinore

Përfundimi i projektit (24-30 muaj):

- Të bëhet përbledhja e rezultateve të planit të veprimit dhe arritjeve e ndryshimeve të bëra për përbushjen e komponentës gjinore të KDRRI-së.

Rekomandime nga palët e interesit:

- Zhvillimi i kapaciteteve duhet të përfshijë trajnimin rreth barazisë gjinore, NK dhe PNK, ZRRF, sistemeve të paralajmërimit të hershëm rreth ZRRF dhe NK.
- Trajnimet dhe ushtrimet praktike për ta përgatitur popullatën për përballimin e fatkeqësive, duke përfshirë skenaret dhe rolet e reagimit ndaj emergjencave, etj.
- Fushatat e vetëdijesimit publik (media, broshurat, interneti për t'u lidhur me njerëz).
- Politikanët dhe zyrtarët vendorë duhet të informohen rreth rëndësisë së ndjeshmërisë gjinore në kuadër të ZRRF dhe NK.
- Rritja e aftësisë së grave për të marrë pjesë në mënurë aktive dhe për të qenë të vetëdijshme për të drejtat e tyre.
- Transparenca dhe llogaridhënia janë tejet të rëndësishme, që do të thotë se duhet të publikojmë sukseset dhe mangësitë tona në lidhje me realizimin e çështjeve gjinore.
- Duhet të mbahen debate publike dhe takime/konsultime publike, të cilat duhet të jenë gjithëpërfshirëse.
- Simulimi publik – fushatat (e emergjencave natyrore) dhe reagimet e përshtatshme, duke përfshirë ato gjinore (këto mund të bëhen përmes programeve televizive dhe fushatave edukuese në shkolla dhe universitete, etj.).
- Java/muaji informativ (rreth ZRRF dhe PNK) mund të mbahet nëpër fshatra dhe qytete; duke përdorur edhe transmetimet televizive të veprimitarive dhe fushtave kulturore për mbulueshmëri më të gjerë.
- Fushatat e informimit publik mund të bëhen nëpër mediume, shkolla e universitete, si dhe derë më derë.
- ZRRF dhe PNK mund të përfshihet në planprogramin e shkollës fillore, të mesme dhe nëpër universitet.
- Duhet të ketë financim të veçantë për zhvillim të kapaciteteve dhe fushata komunikuese.
- Personeli i angazhuar me zhvillim të kapaciteteve në grupin/komititin punues duhet të ketë role dhe përgjegjësi të përcaktuara, si dhe mund të bashkëpunojë me Agjencinë për barazi gjinore.



fotografi grupore e pjesëmarrësve të punëtorisë, të gjithë bashkë (qeveria e Kosovës dhe ojQ-të) për përfshirjen e gjinisë në ~~ZRRF~~ PnK, tetor 2014, Prishtinë.



CADRI, prill 2011, Raporti i vlerësimit të kapacitetit për ulje të rrëzikut nga fatkeqësitë për Kosovë në <http://www.cadri.net/en/where-we-work/kosovo> [e lexuar së fundmi më 24 tetor 2014]

Strategjia për ndryshime klimatike për Kosovë, 2014. Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor (MMPH)

Fetah Halili dhe Agim Gashi, 2009. Raporti i sfondit kombëtar rreth hulumtimit mjedisor për Kosovë (sipas RKSOKB 1244).

Liqji nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, 2011. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 7 / 10 gusht 2011, Prishtinë, Kosovë.

Liqji nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, 2011. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 / 19, 2011, Prishtinë, Kosovë.

Liqji nr. 2004/2, 2004, për barazi gjinore në Kosovë, Kuvendi i Kosovës

Plani kombëtar i reagimit, 2010, Ministria e punëve të brendshme (MPB), raporti

Konsultimi Orgut, 2014, "Profili gjinor i Kosovës - Analiza e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet"

OSBE, qershor 2011, Të vjet pas: Kthimi i minoritetave dhe dëmshpërblimi i shtëpive dhe pronave në Kosovë

Raporti mbi zbatimin e RKSOKB 1325 në Ballkanin Perëndimor, 2013, Komiteti i Helsinkis për të drejtat e njeriut në Kosovë, Vëllimi: Dojsjet Helsinki nr.31], f. 19-20.

UNDP (2013) "Iniciativa për zvogëlimin e rrëzikut nga fatkeqësitë në Kosovë (KDDRI)"

UNDP - Kosovë, 2014, Strategjia për barazi gjinore 2014-2017

UN-HABITAT Kosovë, 2009, Identifikimi i rreziqeve nga fatkeqësitë gjatë planifikimit hapësinor për zhvillim të qëndrueshëm: Studim rasti në Kosovë.

Banka Botërore, 2005, Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Promovimi i mundësive, sigurisë dhe pjesëmarrjes për të gjithë, raporti nr. 32378- XK.

Banka Botërore, 2005, Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Promovimi i mundësive, sigurisë dhe pjesëmarrjes për të gjithë, raporti nr. 32378- XK.



shtojca 1: orari i intervistave

Këshilltarja për përfaqësim gjinor në Zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitetëdhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Misioni në Kosovë 16-18 shtator 2014

Data	Emri	Institucioni	Kontaktimi
E martë, 16.09.2014			
09:00-10:00	UNDP KDRRI & SLED	UNDP	UNDP
10:00 - 11:00	Znjsh. Brikena Sylejmani	UNDP – Gender Associate	brikena.sylajemani@undp.org
12:00 - 13:00	Z. Aleksandar Nikolovski	FAO Kosovo	aleksandar.nikolovski@unfao.org
13:30 - 14:30	Z. Mustaf Gashi	EMA	mustaf.gashi@rks-gov.net
E mërkurë, 17.09.2014			
09:00 - 10:00	Znjsh. Arijeta Himaduna	UN Habitat	arijeta.himaduna@unhabitat-kosovo.org
10:30 - 11:30	Znjsh. Linda Abazi	UNFPA	linda.abazi@unfpa.org
13:00 - 14:00	Znjsh. Edona Hajrullahu	Agjencia për barazi gjinore – Zyra e kryeministrat	edona.hajrullahu@rks-gov.net
14:30 - 15:30	Znjsh. Shpresa Sheremeti	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor	shpresa.sheremeti@rks-gov.net

E enjte, 18.09.2014

08:45 - 09:45	Znjsh. Emine Kelmendi	Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural	merita.ramaxhiku@rks-gov.net emine.kelmendi@rks-gov.net
10:30 - 11:30	Znj. Rezan Zborca Znjsh. Venera Dibra	Zyrtare për çështje gjinore – Ministria e punëve të brendshme	rezan.zborca@rks-gov.net
12:00-13:00	Z. Xhelal Sveqla	Komuna e Prishtinës	-
13:00 - 14:00	Znjsh. Iliriana Jaka Gashi	Gratë për gratë	igashi@womenforwomen.org
14:30 - 15:30	Znjsh. Eliza Hoxha	Arkitekte	eliza.hoxha@gmail.com

shtojca 2: lista e pjesëmarrjes në punëtorinë dy-ditore

Integrating Gender into Climate Change Adaptation and Disaster Risk Reduction / Përfsirja e çështjes gjinore në Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Zvogëlimi të Rrezikut nga Fatkeqësitye

14-15 October/Tetor 2014

Hotel Prishtina



*Empowered lives.
Resilient nations.*

	Institucion	Emri dhe mbiemri	Kontaktimi
1	Ministria e punëve të brendshme, Agjenci për menaxhimin e emergjencave	Nijazi Miftari	Nijazi.miftari@rks-gov.net
2	Ministria e punëve të brendshme, Agjenci për menaxhimin e emergjencave	Muhamet Pllana	Muhamet.pllana@rks-gov.net
3	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor – Departamenti i planifikimit hapësinor	Abdullah Pirce	Abdullah.pirce@rks-gov.net

4	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor – Departamenti i mbrojtjes mjedisore	Zymer Mrasori	Zymer.mrasori@rks-gov.net
5	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor – Departamenti i mbrojtjes mjedisore	Visare Hoxha	Visare.hoxha@rks-gov.net
6	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor – Departamenti i mbrojtjes mjedisore	Adem Tusha	Adem.tusha@rks-gov.net
7	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor – Departamenti i mbrojtjes mjedisore	Miradije Gerguri	Miradije.gerguri@rks-gov.net
8	Kreu i Agjencisë për barazi gjinore	Leonora Selmani	Leonora.selmani@rks-gov.net
9	Ministria e punëve të brendshme – zyrtare për barazi gjinore	Venera Dibra	Venera.dibra@rks-gov.net
10	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor – zyrtare për barazi gjinore	Sevim Berveriliu	Sevim.berveriliu@rks-gov.net
11	Ministria e zhvillimit ekonomik	Lulzim Korenica	Lulzim.korenica@rks-gov.net
11	Gratë e Kombeve të Bashkuara	Barbora Masinova	Barbora.masinova@gmail.com
12	Gratë e Kombeve të Bashkuara	Nita Godani	Nita.godani@unwomen.org
13	Rrjeti i grave të Kosovës	Donjete Berisha	Donjete.berisha@womensnetwork.org
14	Ministria e bujqësisë	Magbule Hyseni	Magbule.hyseni@gmail.com

15	UNDP Kosovo, Gender Associate	Brikena Sylejmani	Brikena.sylejmani @undp.org
16	Komuna e Prishtinës, Departamenti për mbrojtje dhe shpëtim	Ibush Kelmendi	Ibush.kelmendi @rks-gov.net Ibush.kelmendi @gmail.com
17	Komuna e Prishtinës, zyrtare për barazi gjinore	Premtime Preniqi	Premtime.preniqo @rks-gov.org
18	Gratë për gratë	Iliriana Jaka Gashi	igashi@ womenforwomen.org
19	UNDP	Xhevrije Berisha	Xhevrije.berisha @undp.org
20	UNDP	Shkipe Deda-Gjurgjiali	Shkipe.deda-gjurgjiali @undp.org
21	UNDP	Valbona Bogujevci	Valbona.bogujevci @undp.org
22	UNDP	Zana Hoxha-Edip	Zana.hoxha @undp.org
23	UNDP	Dea Haxhi	Dea.haxhi@undp.org
24	UNDP	Shigehiro Shabata	Shigehiro.shabata @undp.org
25	UNDP	Xhevrije Berisha	Xhevrije.berisha @undp.org

